



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 09.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.10.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH"** me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e jashtafatshme kërkesa për rishqyrtim e OE "D & T Group" SH.P.K e dt. 07.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH"** me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 24.04.2024;
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K me date 07.10.2024 (pas orarit të punës, në ora 16:07) ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull **"Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH"** me nr. prokurimi 206-24-3961-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 09.10.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE "D & T Group" SH.P.K:

Neni 1, 6 dhe 7 i LPP-së.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues:

Përveç Formularit B54 për korrigjim që e kemi publikuar me datën 02.10.2024, gjithashtu me këtë datë të lënda në e-prokurim është publikuar edhe Njoftim për Korrigjim të specifikave sipas vendimit të

OSHP-se. Me kete dokument per korrigjimin e specifikave jane te njoftuar te gjithë OE meqense eshte publikuar te Dosja e tenderit ne eprokurimi. Dosja e tenderit publikohet ne fillim te shpalljes se tenderit dhe ajo si document nuk ndryshohet gjate procedures, por korrigjimet me B54 dhe Sqarimet shtese i plotesojne dhe ndryshojne kerkesat e DT.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar Kërkesë për rishqyrtim me datë 07.10.2024 ne ora 16:07, ndërsa hapja e ofertave eshte parapare me datën 10.10.2024.

Dita e Kërkesës për rishqyrtim, data 07.10.2024 eshte dita zero (0) sipas nenit 63.2 te RPPP;

Dita e parë (1) eshte 08.10.2024, dita e dyte 09.10.2024, dita e trete eshte dita e hapjes se ofertave 10.10.2024.

Dita e dorëzimit te ofertave është dita zero (0), qe i bie se janë vetëm dy dite ne mes këtij afati.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit te fundit te lejuar 5 dite para dorëzimit te ofertave.

Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit publik

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miralimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtror një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).


AK hedh poshtë ankesën e parashtrua ne përputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen përcakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

02.10.2024, Prishtinë

Aktiviteti i prokurimit: “Furnizim me Autoambulanca BLS për nevoja të QKMF-ve në kuadër të KPSH”

Nr1 i prokurimit	206-24-3961-1-1-1
------------------	-------------------

Njoftim për KORRIGJIM

Korrigjohen specifikat e teknike të aneksit 1 të DT, pas vendimit të OSHP-se nr. 2024-0718

Në kuadër të AK-MSh, Grupi punues për hartimin e specifikave teknike për ankesën në aktivitetin për furnizim me Autoambulanca BLS ka shqyrtuar me kujdes kërkesat dhe sygjerimet e OSHP, andaj grupi punues mendon që përveq pikës 2 që flitet për transmetuesin e automjetit, në pikat tjara jemi dakort që mund të rregullohen sipas propozimit të OSHP-se.

Kurse sa i përket transmetuesit automatik, AK-MSh konsideron se është jashtë standartëve të BE që ende të punohet me transmetues manual, kurë veq dita ditës janë duke e zënë vendin automjetet Elektrike, andaj ndrruesit e shpejtesive duhet të jene automatik.

Sqarim rreth Pretendimit nr. 1

Kërkesa e OE ankues që të mundesohet autoambulanca me një rezervuar – OSHP ka konstatuar se ky pretendim është i bazuar - edhe AK pajtohet që autoambulancat të jene **me një rezervuar**.

Sqarim rreth Pretendimit nr. 2

Kërkesa e OE ankues ka qene që të mundesohet autoambulanca me transmision manual – OSHP ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar - edhe AK pajtohet që autoambulancat të jene **me transmision automatik**.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Sqarim rreth Pretendimit nr. 3

Kerkesa e OE ankues ka qene qe gjerësia e përgjithshme e autoambulances te jete min 2000mm dhe max 2100m (ndersa eshte kerkuar gjerësia e përgjithshme e ambulancës duhet të jetë rreth 2000mm, duke përjashtuar pasqyrën, dritat dhe aksesorët e sigurisë) - OSHP ka konstatuar se ky pretendim është i bazuar - edhe AK pajtohet qe autoambulancat te jene me gjerësi nga 2000 mm në 2100 mm.

Sqarim rreth Pretendimit nr. 4 dhe 5

Kerkesa e OE ankues ka qene qe te lejohet një tolerance prej $\pm 5\%$ te specifikat e pajisjeve mjekësore - OSHP ka konstatuar se ky pretendim është i bazuar - edhe AK pajtohet dhe lejon një tolerance prej $\pm 5\%$ te specifikat e pajisjeve mjekësore.

Sqarim rreth Pretendimit nr. 6

OE ankues ka paraqitur disa mangësi për veturat që tërheqin me rrota të prapme, siç janë kërkuar nga AK, dhe ka përmendur disa përparësi për veturat që tërheqin me rrota të para. Ajo ka sqaruar se kjo është në kundërshtim me nenin 28, paragrafin 2, sepse vendosja e këtij kriteri përjashton shumë prodhues dhe favorizon vetëm prodhuesit që tërheqin me rrota të prapme - OSHP ka konstatuar se ky pretendim është i bazuar - edhe AK pajtohet dhe lejon ofertimin me autoambulanca me terheqje ne cilen do forme, te perparme apo te pasme.

Me respekt,

Div. i Prokurimit ne MSh